

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI EKONOMIK



**NDIKIMI I KARAKTERISTIKAVE TË  
PERSONALITETIT NË STILIN E VENDIMARRJES  
DHE SJELLJEN INOVATIVE NË VENDIN E PUNËS**

QËNDRESË IBRAHIMI

2024

## Abstrakt

Qëndrimet dhe sjelljet e menaxherëve në vendin e punës kanë rëndësi esenciale për suksesin dhe zhvillimin e organizatës në tërësi. Mënyra se si niveli menaxherial merr vendimet e rëndësishme, bazuar në karakteristikat individuale, është themelore për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi në vendin e tyre të punës. Aftësia për të marrë vendime cilësore është kyçe për rritjen dhe zhvillimin e organizatës në përgjithësi. Në një mjedis të ndryshueshëm dhe dinamik, qasja inovative është e rëndësishme për mbijetesën dhe konkurrueshmërinë e kompanisë. Stili i vendimmarrjes është një mjet që ndihmon për të kuptuar mënyrën se si individët përdorin informacionin për të marrë vendime, dhe pse menaxherët, të përballur me situata të ngjashme, mund të përdorin procese të ndryshme vendimmarrëse.

Ky disertacion i doktoratës ka si qëllim kryesor identifikimin e stileve të vendimmarrjes së menaxherëve bazuar në karakteristikat e personalitetit të tyre dhe ndikimin që ato kanë në sjelljen inovative në vendin e punës. Pas një analize të punimeve të tjera të realizuara në këtë kontest, është vënë re mungesa e hulumtimeve që trajtojnë këtë temë, duke i dhënë kështu këtij punimi një rëndësi të veçantë. Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur modeli i ndërmjetësimit, model ky i cili mundëson për të përcaktuar nëse variabla ndërmjetësuese – stili i vendimmarrjes, ka ndikim në marrëdhënien në mes të variablës së pavarur – karakteristikave personale dhe variablës së varur – sjelljes inovative në vendin e punës.

Ky studim është i veçantë, pasi trajton lidhjen midis personalitetit dhe sjelljes inovative, dhe e bën këtë përmes modelit të ndërmjetësimit, një qasje që nuk është eksploruar gjerësisht në literaturë, sidomos në kontekstin e Kosovës. Rishikimi i literaturës tregon interesin e madh që ka kjo temë për studiuesit globalisht.

Rezultatet e punimit tregojnë se ekstraversioni nuk ka ndikim të rëndësishëm në stilin racional, intuitiv dhe të varur të vendimmarrjes, por ndikon negativisht në stilin shmangës dhe spontan. Pajtueshmëria nuk ka ndikim të rëndësishëm në asnjë stil, ndërsa vetëdijësimi ndikon vetëm në stilin racional dhe shmangës. Stabiliteti emocional ka ndikim në stilin racional, intuitiv, shmangës dhe spontan, por jo në stilin e varur, dhe hapja ndaj përvojave ndikon në stilin racional, shmangës dhe spontan, por jo në stilin intuitiv dhe të varur. Stili racional dhe intuitiv i vendimmarrjes kanë ndikim të rëndësishëm në sjelljen inovative në

punë ( $p = .000$ ), ndërsa stilet e varur dhe spontan nuk treguan ndikim të dukshëm ( $p > .05$ ). Pajtueshmëria, vetëdijësimi, stabiliteti emocional dhe hapja ndaj përvojave ndikojnë në sjelljen inovative në punë, ndërsa ekstraversioni nuk ka ndikim të rëndësishëm. Gjithashtu, stilet e vendimmarrjes nuk ndërmjetësojnë ndikimin e karakteristikave të personalitetit mbi sjelljen inovative në vendin e punës.

**Fjalët kyqe:** karakteristikat personale; stili i vendimmarrjes; sjellja inovative në vendin e punës; menaxherët;